

GJON GJERGJA

Berisha  
1992

# BUKUROSHJA E DITËT

**Gjon Gjergjaj  
BUKUROSHJA E DETIT**

**Biblioteka  
"GURAKUQI"**

**Redaktor  
RIFAT KUKAJ**

**Recensent  
ARIF DEMOLLI**

GJON GJERGJAJ

**BUKUROSHJA E DETIT**

RILINDJA  
Prishtinë  
1992

## LINDI DIELLI

Me zog e cicërim'  
këngët çelin fushës,  
diell i fshatit tim  
qesh në sy t'drenushës...

Ëndrrat i hapëruan  
me fustan t'artë  
një çikëz pushuan  
majë plepit t'lartë...

## LUMI MË KRUSHQ

Krahët e lojës i hap vera,  
Kallinjtë n'arë i puth era...

N'vesh vë ëndrrën si qershinë,  
Zemra e rrezes rrëzëllin.

Përrallat buzë lumi rrush,  
Mirusha me ujëvaret prush.

Nga i mori buzëqeshjet si ar?  
Prej lumi nga krushku i parë.

## LISIT

Ti  
që u bëre hije krojeve  
që tokën e forcove me eshtra,  
që ëndrrave u dhe shpirt,  
që ua mësove udhën e largët,  
që diellin e mbajte në prehër,  
që ujkut ia shkurtove rrugën,  
tani lis miku më i mirë,  
hapi krahët, merr frymë i lirë,  
hapi krahët, merr frymë i lirë!.



## FSHATARI IM

Djersë e farë në ara,  
mundimet i mbijnë si lule,  
ec tehut të furtunës,  
zemrën e shtron si sofrën,  
gjaku i këndon fli,  
dashurisë ia mëson rrugën e humbur  
skaj hullive t'buzëqeshura,  
skaj hullive t'buzëqeshura!

## PËRALLA LËPIHET SI AKULLORE

Vendi ku pushoi dielli,  
ku u puthën ëndrrat,  
ku dashuria kishte rrugën,  
ku mali kishte këngën,  
ku besa kishte zogun,  
ku dreri kishte strofkën prore,  
ku përralla lëpihet si akullore,

aty kush e ka shtëpinë?  
Përralla që rrit fëmijërinë...

## PËR NËNËN

Për ty  
lulet  
vrapojnë pas rrezeve  
të ta ngrohin zemrën,  
vrapojnë pas zogjve  
të ta fshijnë lotin  
e ta shtojnë blerimin,  
lulet  
i shterrin krojet,  
thithin freskinë,  
të ta shtojnë dashurinë,  
nënë, o nënë!

## TROKITJE E BARDHË

Në derë t'shtëpisë  
lejleku trokiti  
n'vetullë t'çatisë  
një rreze ndriti.

Me fëmijë gëzojnë  
ara e fusha,  
erën shalojnë  
bashkë me drenusha.

E çup'zave këngë  
si valëza n'sheje  
fshatit pa brengë  
n'dridhje hareje...

## **LOJA E THYER**


**Lulja çel dhe në flakë t'pushkës,  
erë baroti afsh i bukës...**

**Dhunën shtruan dhe mbi ugare  
hijet e errëta - barbare.**

**Loja u thye në shteg të hënës,  
klidhje e fortë në zemër t'nënës.**

**Zogjtë i helmuani në gjii t'shkollës  
me dorë gjarpri, me gjuhë t'bollës.**

**Ky gabim t'ligut s'i falet:  
si s'e di që s'trembën malet?!**



## **MBYLLET DERA, HAPET DERA**

Mbylllet dera, hapet dera-  
dënes dimri, qesh pranvera,  
mbylllet dera, hapet dera-  
ik' lulebora, vjen lulevera.

Mbylllet dera, hapet dera-  
del gjyshi, futet nipi,

mbylllet dera, hapet dera  
porsi çorapëgjata Pipi.

Mbylllet dera, hapet dera,  
nxiton lumi, e pret deti,

mbylllet dera, hapet dera,  
kështu rrapiillon me fjalë poeti.

## TI E DRINI

- Mjegullën kush e gris?
- Drini bashkë me ty.
- Terrin kush e shashtis?
- Guximi në sy.

## SI GJYLE TOPI

- Oj dada Rukë  
si i ke "çakajtë",  
a t'përngajnjë ty,  
apo janë si dajtë?

- Po, moj Dila e Palit,  
por rriten, ka dashur Zoti,  
po rriten, po rriten  
si gjyle topi.

- T'i shohësh, oj Dilë,  
s'janë aq të mëdhenj,  
por nga toka e vet  
kush s'i ndan, hej!

Cilikoj si guri  
kur t'i ka deti,  
kënaqen fushë e mal,  
kënaqet mileti.

Toka merr frymë  
n'oxhak e n'trëndafilë  
oj dada Rukë,  
o lokja Dilë!

## **BUZËQESHJET**

Dielli buzëqesh  
lulja hapi petalet  
sa këtu e në kreshtë  
nëna Bute krahët...

Lejlek i bardhë  
oxhakun merr në gji,  
dy sytë e hareshëm  
por si dy inxhi.

Këngë krojesh rrjedh  
nënës damarëve i shket:  
Si kaproll nën bredh  
Ti paç shëndet!

## HAP DERËN GUR OXHAKU

Hap derën gur oxhaku  
njerëz si valët e Drinit  
për ta vrarë te praku  
ëndrrën e krimit.

Krushq të mallëngjyer  
ligjërojnë si det  
një rreze e shkëlqyer  
në shtëpi hyri vet.

Çohet xha Sokoli  
kur e lyp ujdia,  
dhe i fal gjaqet  
vritet hasmëria.

Kulla flet një fjalë:  
- O burra, aferim,  
le t'rriten vajzë e djalë  
pa drojë, trishtim...

Bjeshkën me bjeshkë  
pajton Anton Çetta,  
Krahpërkrash me Drinin  
bardh rrjedhjeta...

*Zllakuqan, më 25.06.1990*



## JANË DY KROJE

Në fshatin tím  
janë dy kroje,  
njéri: ujët pelim,  
tjetri: mjaltë e hoje.

Fëmijë e zogj vijnë  
e pinë në krua të mirë,  
fluturojnë në krahët  
e motrës dëshirë.

Janë do njerëz t'marrë  
që s'pinë ujë të mirë,  
ëndrra, punë, e jetë:  
pikëllim e trazirë...

## **YJET NË TOKË DO T'I ZBRES**

Këngët do t'i ques në pe,  
do t'i bëj qafore.

Ëndërrat do t'i kthej në ballona  
hapësirës qiellore.

Yjet në tokë do t'i zbres  
ta ngrehin lumin n'mëngjes.

Këmishën do ta qëndis me flutura  
a s'janë këto ëndrra të bukura?

## I MADH ËSHTË DETI

Më freskuan ca sferëza  
nga fqinji im,

e ai kafshoi ëndrrën  
në fluturim.

Të gjitha të zezat  
le t'i ruajë për veti,-

i madh është deti,  
i gjerë është deti...

## **JETA KA HALA**

**Peshku u ankua:  
gjithkah marrin n'thua.  
Le tē ndryshkēn grepat  
le tē blerojnë plepat.**

**Tē griset çdo rrjetë,  
tē bëjmë gjumë tē qetë!**

**Meqë ra fjala:**

**Jeta ka hala,  
Jeta ka hala!**

## NINULLA

Lejleku, thanë, më pruri  
kur nxori kallirin gruri.

Hapi derën pranvera,  
ia nisi këngës vera.

Zogu i ri me fletë  
ledhi qiellin, retë.

Ninulla ç'flamur valon?  
Atë që nëna dëshiron.

## DASHURIA MË SOLLI NË JETË

Thonë, lejleku shend e verë  
me foshnjë troket në derë...

Si më solli vallë në jetë  
me sqep e krah të lehtë?

Kjo është rrenë se ç'na polli:  
lejleku kurrë s'na solli!

E vërteta është e vërtetë:  
dashuria më solli në jetë.

Prindërve të mirë e të mbarë  
në kopsht u çeli lulja e parë.

## JETA JONË S'ËSHTË DREQ ME BISHT

Këndon mali  
malërisht,

rrezon dielli  
diellërisht,

udhëton lumi  
lumërisht,

rrëfen guri  
gurërisht,

ëndërron ylli  
yllërisht,

jeta jonë  
s'është dreq me bisht.

## **PESHQIT E PËRFLAKUR**

**Fluturat zbukuruan qielin  
buzëqeshjet e rritën diellin.**

**Ç'u bë fryshtimi i poetit?  
Po i shalon peshqit e detit.**

**Pse po duken si të përflakur?  
Erdhën me një lumë t'përgjakur!**

**E plagosen me mëri  
vetëm pse quhet - Dri...**

## ZOGU I MËRGUAR

I ri pse ka vajtur  
ai zog në kurbet?!  
Jetën për të mbajtur  
në shtëpinë e vet...

Lule nis nga larg  
të shkurtojë largësinë,  
në to dënesat-varg,  
mallëngjejnë shtëpinë.

Punë ndaj të gdhirë  
deri në mbrëmje  
i mërguar-martir  
që t'mërgojë dhembje.

## **PIKËÇUDITËSE E MJERIMIT**

**Të ngrohtë jemi -  
sepse kemi  
lumin, rrugën, shpresën.**

**Deti  
me liman të ngrirë  
pret anijen e bardhë.**

**Pikëçuditëset e mjerimit  
kryqëzohen  
në pikën e zezë.**

**Diell kurbeti  
ka hapur rrjetën,  
lumenj djerse, loti  
vërshuan jetën...**

## PËR DEGËN E BLERTË

Zogu ra në lak,  
loja pikoi gjak.

Shpresa kërkoi yllin,  
Ylli ndriti pyllin.

N'shtek hingëlloj Gjoku,  
po e shalonte zogu.

Drini rrjedh e shket  
drejt detit të vet...



## DIMRI

Veriu ia këndon këngë-fërfellizën,  
me akull duke ia prerë kërthizën!

Ballin e ka të mbuluar me re,  
në lumë dridhet, dridhet në shé,  
në shpinë i hipin djaj e kukudhë  
e shalojnë udhëve të paudhë,  
  
krushqinë e bën me acar,  
tre muaj është krushk i parë...

## E LANË LËKURËN

Këndej ranë  
e më s'u panë.

Këndej ikën,  
dritat fikën.

Nëpër lumë  
s'bënë gjumë.

Kaluan urën,  
po lanë lëkurën.

## MALLKONTE SHIUN:

Sa krenar  
para gjarprit tē parē,

fytafyt  
me gjarprin e dytë,

përpjekje e vërtetë  
me gjarprin e tretë.

Derisa bishë e zezë  
shkilte lulet në mëngjes.

Dhe mallkonte e mallkonte  
shiun që në to ëndërronte!

## FYELLI MAGJIK

Erën e zë  
për bisteku -  
Merimangës ia heq pëlhirën nga veku.

Frikës ia pres bishtin  
me sharrë -  
sharrën e thyej para se t'hyjë në mal.

Lumit ia marr timonin, e drejtoj  
për Bajgorë -  
Mollat i regjistroj në shkollë.

Peshqit i mësoj ta prarojnë  
liqenin -  
Kalit të ëndrrës ia heq frerin.

Kapela më mëson aktrimin:  
bukur imitoj Çarli Çaplinin.

Dora ime çdo gjë  
mrekullon -  
Fyelli magjik kur më shoqëron.

## ME PIKA E PRESJE

M'rrejte t'rrejta,  
borxh më mbete,  
me gënjeshtra  
sa larg trete...

M'tore t'tora,  
më dole ferrë,  
pabesia  
t'bën tē djerrë.

Plus minus  
minus plus,  
e blen pulë  
e tē del këndu's.

Kështu jeta -  
kthesë pas kthese,  
me pika e presje,  
me pika e presje.

## DRINI I BARDHË PI ASPIRINË

Prillamiri  
nëse shëtit n'pixhama,  
gulçon, kollitet,  
e mbërthen flama.

Kur fryn era  
tështin lumi,  
hundët i ndjell  
dhe s'e zë gjumi.

Drini i Bardhë  
asprinë pi,  
ndaj ka ethe,  
por nuk e di.

## FËMIJA KA ÇELËSIN KU RRITET KALTËRIA

Ëndërr e kaltër  
në Lumin e Kuq,  
është Ëndërr e Madhe,  
ëndërr me krushq.  
E ti shëtit  
pranverë më pranverë,  
t'i hapin dritaret,  
ta hapin çdo derë.  
T'i hap Blini  
librat-pallate,  
me shkronja Drini  
të hip nëpër kate.  
E me Agimin  
je lule në livadh,  
me Dukagjinin  
n'Planetin e Madh.  
E ti e di  
ku lahet Dashuria,  
paj Çuni e ka çelësin  
ku rritet kaltëria.

## Ç'ËSHTË FSHEHUR NË GOTË?

Një ëndërr më jep shenjë  
të shkruaj poezi,  
s'më lë rehat të fle:  
çohu, shkruaj, mos rri!

Njëqind herë e ndez dritën,  
njëqind herë e fik,  
herë kalon ëndrra,  
herë mbetet n'trafik.

Më shëtit ëndrra prore  
e unë jep e merr,  
poçi im i kredhur  
e fshehur në terr!

## LIRIA

Liri është  
kur dreri e ka shtëpinë  
aty pranë vreshtës,  
liri është  
kur dielli i buzëqesh  
ëndrrës së laureshës.

## BUKUROSHJA E DETIT

Zhytemi mbytemi  
deri në fund deti,  
ecim pas frysëzimit  
të një poeti.

Zemrat stolisin malin  
ujëvareve të Mirushës,  
ç'gjurmojnë ata çuna  
trëndafila të fushës?

Bukuroshja e detit  
solli në Miradi  
valët e argjendta  
për mua e për ty.

## ËNDËRRAT TROTUARIT

Ëndërrat trotuarit  
sillen e sillen,  
kur takohen,  
dridhen, dridhen.  
Ngrohtë hepohen  
si valë lumi,  
ledhatohen  
me krahë pëllumbi,  
e buzëqeshjet  
gërsheetohen,  
n'lumenj dëshirash  
reflektohen.

## ME DY PALË SY

Ti e di një,  
unc i di dy:  
një është e botës  
një është për ty.

Përrallë e lashtë  
ka botën e detit,  
lulëkuqja prek  
flokët e poetit.

Pranë vatrës  
nga gojë e plakut  
ndrit, këndon  
flakë e oxhakut.

Kulla më ka mua,  
kulla të ka ty,  
dritaret hapur  
me dy palë sy.

## **LIBRI**

**Gjirin e ndritur ta shpurpuris  
si bleta petalet.**

**Aty ligjerim gurash  
e cicërimë zogjësh.**

**Aty ëndrrat jetojnë  
që si pranverë blerojnë.**

**Kush dëshiron bëhet manushaqe,  
kush do sy i mësueses,**

**Mund të bëhesh udhë e jetës,  
po deshe, velanije në oqeane.**

## ORË E ÇAST

Orë e çast  
orë e çast  
syri-syrin  
puth me gas.

Orë e çast  
orë e çast  
lulja e kuqe  
më vjen pas.

Orë e çast  
orë e çast  
vetëm para  
e jo pas.

Orë e çast  
orë e çast  
vaji me vaj  
gazi me gaz.

## HAPI

Dikush ka hap tē madh  
dikush ka hap t'vogël,  
dikush s'jepet kurrë  
dikush: dushk pér gogël.

Dikush ka hap deti,  
dikush ka hap lumi,  
dikush ka ēndërr poeti,  
dikush zemër pëllumbi.

Dikush çalon,  
dikush gabon,  
dikush pritet,  
dikush rritet.

Dikush ha  
dikush qan,  
dikush shitet,  
dikush s'shihet.

## MOS LUAJ ME SHUMË LETRA

Zog, mos luaj  
me shumë letra,  
në dorë të mbesin,  
t'bëhen të vjetra.

Nuk të duhet  
ty ajo lojë,  
në fund mbetesh  
me gishta në gojë!

Mos trembëdhjetëshin,  
se mbete brenda,  
nuk bën të shiten  
lulet për lenda.

## EC E QËLLOJA

Veja është më e vjetër se pulë,  
pula është më e vjetër se veja.  
E di si erdhi në jetë veja?  
E di si erdhi në jetë pulë?

Ec e qëlloja  
cila është më e vjetër,  
ec e qëlloja  
a ka rrjedhë tjetër?

Njeriu erdhi në jetë thjesht  
si dashuria që vjen në jetë.

Ec e qëlloja cili lindi i pari:  
njeriu apo dashuria,  
drejtoja gishtin!

Ec e qëlloja cili lindi më parë  
mos ia nxirr bishtin!

## NË KAPËRCYELL

Në ëndërr pashë  
t'rreptë një përpjekje:  
kulçedrën me malin  
për jetë a vdekje.

Filloj në bjeshkë  
bubulloj në vërrri,  
mjegulla pështillej,  
plumb binte shi.

Gurrat ç'lotonin,  
lisat çanin krahët,  
ç'vyshkeshin lulet,  
ç'goditnin bahet!

Ajo shtatëkrerëshe  
e pa zezëditën,  
në kapërcyell kohësh  
ia patën zënë pritën.

U përndrit vendi  
shkëndija, flakë,  
kërthizën t'ia prenin  
kulçedrës plakë.

## DORA E ZEZË

Një Dorë e Zezë  
lodra ka vrarë,  
bota e tërë  
krimin ka parë.

Pse Dorë e Zezë  
po bën krim,  
pse vret e pret  
e sjell trishtim?

Fytyrëxhelati  
kaloi shumë kodra;  
ëndrra varrosi,  
varrosi lodra.

Ai voc i Pishës  
loti i rriddha faqes,  
me facoletë pikëllimin  
ia fshinte Manushaqes.

## MISRI E GRURI

**Misri koburet në brez,  
gruri mustaqet dredh.**

**në qiell lauresha-shkëndijon,  
këngën e bukës - reciton.**

**Skaj lagjes e shihni plakun  
gjithë gaz dredh mustakun:**

**Të lumtë, ty vesë e mbarë!  
Qeshuni, kosh e hambar...**

## MOLLËKUQJA MËSITE

Loja është lojë,  
një bukramirë;  
pakëz me drojë  
shpreh një dëshirë...

Kur isha i vogël  
zura një mollëkuqe  
tek lozja n'livadhe  
dhe e luta  
të ma zërë  
një nuse të madhe:  
- Oj mollëkuqe,  
sillma një nuse!

Fluturoi mollëkuqja  
përtej Drini  
dhe andej  
qenka gjëzimi...  
Nusja më pret  
me shërbet...

## KAPËRCEVA DRININ

Kapërceva Drinin  
Ta kreh krifën e kalit,  
shalova këngën  
parzmës së malit.

Ç'ëndërr fantastike:  
fluturoja n'qiell-  
në garat Olimpike  
bashkë me një kërmill.

Shalova lumin  
e hodha detin,  
ta zgjoj frymëzimin  
thellë në poetin.

## GATUAJMË

Ulemi buzë lumi  
në një pasdite,  
me rërën e butë  
gatuajmë njëqind pite.

Kjo lojë e shijshme,  
e lojë pas loje...  
Karkaleci qeshte  
mbi fletë têrfoje.

Vrapuam pas lumit  
me flokët në erë  
peshq zgjuam prej gjumit  
me gaz e poterë...

Fundin e ditës  
e t'lodhurin hap  
në majë të grepit  
e dridh një krap!

## GJERDAN DREDHËZASH

Do t'i fus të gjitha ëndrrat  
varg në pe, si dredhëzat.

Do t'ia var n'qafë gjerdan,  
vëllait tim - Dardan.

Sapo t'i sheh n'gurrë, si blerim,  
do t'i tretë çdo pikëllim.

Po kur t'bjerë ai në gjumë,  
mos ia qukit ndonjë pëllumb.

## DORË E PAPARË

Lulet shuajnë etjen,  
zogjtë lagin sytë,  
kur këndojnë  
bareshat lozonjare  
me gisht në fyt.

Një dridhje zemre  
e djaloshit  
dhe nulla  
marrin të mbarën,-  
një dorë e paparë  
sikur hap dritaren.

## AI ËSHTË RRUSHI

E sheh e s'mund ta arrish -  
ai është rrushi,  
buzëqesh e me të mund të rrish -  
ai është rrushi,  
zemra të therr kur del në derë -  
ai është rrushi,  
lart mbi krua më rri pérherë -  
ai është rrushi,  
çdoherë nuk rri e më shkruan letër -  
ai ëshë rrushi,  
më porosit të dal patjetër -  
ai është rrushi,  
dashuria na pëshpërit gjithnjë -  
ai është rrushi,  
nuk çmallem duke e shikuar atë diell -  
ai është rrushi,  
e Ai shëtit e shëtit nëpër qiel -  
po, Ai është rrushi.

## ÇFARË KËMBËSH KA DIELLI?

Ka vatër të artë,  
ka atdhe të zjarrtë.

Duart i ka të buta,  
fjalët i ka të urta.

Me secilin është shok,  
njerëzinë bën tok.

Plagë e vuajtje, i bën lule,  
kurrë s'di për përkulje.

Këmbët i ka të rrezeve,  
ngjyrën e ka të dredhëzave.

Mos është syri i gjithësisë,  
që pa dhe plagët e Gjergj Elez Alisë?

## KUKUBECI

Ai që i frikëson fëmijet  
ka kokën me kashtë,  
ai që i frikëson fëmijët  
rri në terr, jashtë,  
ai që i frikëson fëmijët  
në kopsht bën roje,  
ai që i frikëson fëmijët  
jeton mes fshesave,  
i ka lakmi sorrat  
atje majë lisave,  
ai që i frikëson fëmijët  
ka kokën me kashtë,  
është dënuar t'jetojë  
në vetminë e lashtë...

## NUK HAHET DJATHI PA BUKË

Picirruk, picirruk,  
nuk hahet djathi pa bukë!

Teket e djalit t'llastuar -  
n'sy t'nënës lot i përvëluar.

Nëpër skamje nënë e shkretë  
mezi po të mban në jetë.

S'mund të t'shtrojë sofër t'plotë,  
ndaj kurseja ndonjë lot...

# PËRMBAJTJA

Lindi dielli . . . . .	5
Lumi me krushq . . . . .	6
Lisit . . . . .	7
Eshatari im . . . . .	9
Përralla lëpihet si akullore . . . . .	10
Për nënën . . . . .	11
Trokitje e bardhë . . . . .	12
Loja e thyer . . . . .	13
Mbylljet dera, hapet dera . . . . .	15
Ti e Drini . . . . .	16
Si gjyle topi . . . . .	17
Buzëqeshjet . . . . .	18
Hap derën gur oxhaku . . . . .	19
Janë dy kroje . . . . .	21
Yjet në tokë do t'i zgres . . . . .	22
I madhi është deti . . . . .	23
Jeta ka hala . . . . .	24
Ninulla . . . . .	25
Dashuria më solli në jetë . . . . .	26
Jeta jonë s'është dreq me bisht . . . . .	27
Peshqit e përflakur . . . . .	28
Zogu i mërguar . . . . .	29
Pikëçuditëse e mjerimit . . . . .	30
Për degën e blertë . . . . .	31
Dimri . . . . .	33
E lanë lëkurën . . . . .	34
Mallkonte shiun . . . . .	35
Fyelli magjik . . . . .	36
Me pika e presje . . . . .	37
Drini i Bardhë pi aspirinë . . . . .	38
Fëmija ka çelësin ku rritet kaltëria . . . . .	39
Ç'është fshchur në gotë? . . . . .	40
Liria . . . . .	41
Bukuroshja e detit . . . . .	42
Ëndërrat trotuarit . . . . .	43

Me dy palë sy	44
Libri	45
Orë e çast	46
Hapi	47
Mos luaj me shumë letra	48
Ec e qëllloja	49
Në kapërcyell	50
Dora e zezë	51
Misri i gruri	52
Mollëkuqja mësite	53
Kapërceva Drinin	54
Gatujmë	55
Gjerdan dredhëzash	56
Dora e paparë	57
Ai çështë rrushi	58
Çlare këmbësh ka dielli	59
Kukubeci	60
Nuk hahet djathi pa bukë	61

**Montazhi**  
*Orhan Nurkollari*

**GJONGJERGJAJ BUKUROSIJA E DETIT/Kopertinë dhe ilustrime**  
**Idriz BERISHA/Rëdaktori teknik Shenisi GËRGURI/Korrektor**  
**Sabit JAHIA/Radhiuja kompjuterike -INFOTRADE-/Prishtinë**  
**1992/Radhitës Muhamed LEPAJA/Realizimi kompjuterik Lirak**  
**CETAJ/Tirazhi 2000 copë U shtyp në Shqipshkronjën e NSHG**  
**"BERATI" Prizren**

Gjon Gjergjaj u lind më **15. 02. 1951** në fshatin Krushevë e Vogël të Klinës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Klinë. Është punëtor, në KK të Klinës. Më 1989 Redaksia e botimeve »Rilnidja« ia botoi librin me poezi për të rritur me titull »**LISAT E NAKLLIT**«. Shkruan poezi për fëmijë, shumë nga të cilat i ka botuar nëpër faqet e revistave dhe të gazetave tona. Si aktor amator ka luajtur me sukses në disa shfaqje të seksionit të dramës të shtëpisë së kulturës »Jehona e Dukagjinit« të Klinës. Merret edhe me skulpturë.

